

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

E.Rev.nr.2/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Shukri Sylejmani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtar kolegji, në çështjen juridike të paditëses N.N.T A. K., me seli në Gj. të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Bardh Maksuti, avokat nga Gj., kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V. Sh., objekt i kontestit pasurim i pa bazë, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për çështje ekonomike Ae.nr.54/21 datë 16.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 05.05.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i të autorizuarit të paditëses, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për çështje ekonomike Ae.nr.54/21 datë 16.09.2021.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për çështje ekonomike Ae.nr.54/21 datë 16.09.2021, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses N.N.T A. K., me seli në Gj., dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themeleore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.247/19 datë 23.11.2020, me të cilin në pikën I.të dispozitivit refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses kundër të paditurës që të detyrohet e paditura që në emër të pasurimit pa bazë paditëses t'ia paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 296,005.44 €, me normë të kamatës prej 8 % në vit e cila fillon të rrjedh nga data 05.10.2015, e deri në pagesën definitive, që të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën

definitive. Ndërsa me pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të sipër cekur të gjykatës së shkallës së dytë, i autorizuari i paditëses me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe aplikimit të gabuar të së drejtes materiale, me propozim që Gjykata e Supreme e Kosovës, të aprovoj revizionin si të themeltë, dhe të dy aktgjykimet e sipër cekura t'i prishë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose që t'i ndryshoj ashtu që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë si të bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë kontestimore (LPK) shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e të autorizuarit të paditëses, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

-Revizioni i të autorizuarit të paditëses është i pa bazuar.

Në procedurën e zhvilluar në shkallë të parë, Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet se:

-nga kontrata me nr..., me titull "sanimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Gjakovës, rezulton se pala paditëse dhe pala e paditur kanë qenë në raport kontraktues. Pala paditëse ka marrë detyrimin e kryerjes së punimeve sipas nevojës dhe pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike. Çmimi i kësaj kontrate ka qenë në shumën prej 49,50 €, për njësi.

-nga situacioni i dt.05.10.2015, i lëshuar nga pala paditëse në procedurë rezulton se pala paditëse ka kryer punime ndërtimore në objektin U. mbi lumin E., në vlerën prej 187,150.44 €.

-nga situacioni i dt. 05.10.2015, rrjedh se në objektin rruga lokale L., në Gjakovë, rrjedh se pala paditëse ka kryer punime në vlerën prej 181,150.44 €.

nga fatura me nr..., e datës 05.10.2015, e lëshuar nga pala paditëse rrjedh se vlera e punimeve të kryera në rrugën lokale L., është në shumën prej 108,855.00 €.

-nga fatura me nr..., e datës 05.10.2015, e lëshuar nga pala paditëse rrjedh se vlera e punimeve të kryera në rrugën lokale L., është në shumën prej 187,150.44 €.

-më datën 23.10.2015, pala paditëse ka parashtruar propozim për përmbarim tek Përmbaruesi Privat Gj. R., dhe i ka propozuar përmbaruesit në fjalë që të lejoj përmbarimin në bazë të faturave dhe të urdhërohet pala e paditur Komuna e Gjakovës që t'ia kompensoj shumën e mjeteve në

lartësinë prej 296,005.44 €, në emër të punimeve ndërtimore të kryera. Përmbaruesi Privat me urdhrin P.nr.737/15, e ka lejuar përmbarimin e propozuar.

-nga aktvendimi PPP.nr. 77/17, i Gjykatës Themelore në Gjakovë rrjedh se gjykata e ka aprovuar prapësimin e debitorit këtu Komuna e Gjakovës dhe është anuluar urdhri përmbarimor P.nr.737/15, i Përmbaruesit Privat, dhe i ka anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra në atë procedurë. Sipas aktvendimit në fjalë punimet janë kryer pa miratimin e Zyrës së Prokurimit Publik, dhe se nuk kemi marrëdhënie kontraktuale në mes të palëve në procedurë. Andaj gjykata këto fatura i ka konsideruar si fiktive dhe se nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore për përmbarim.

-nga aktvendimi Ae.nr.2348/2018, rrjedh se ankesa e parashtruar nga kreditori, këtu paditësja është refuzuar si e pa themeloret dhe aktvendimi PPP.nr. 77/17, me të cilin është anuluar urdhri përmbarimor është vërtetuar.

-nga raporti i ekspertizës nga lëmi i ndërtimtarisë rrjedh se punimet mbi lumin E.-U. e M., janë kryer dhe se ura është në funksion. Mirëpo nga asnjëra palë në procedurë nuk është prezantuar dokumentacion i nevojshëm siç janë: Kontrata e lidhur në mes të palëve; projekti i pranuar; situacionet e pranuar dhe të vërtetuara nga investitori; ditarët ndërtimor; libri ndërtimor; plani dinamik për ndërtimin e objektit; procesi i pranim dorëzimit të punimeve, e as llogaria përfundimtare e punimeve të kryera e të nënshkruara nga të dyja palët. Në sqarimet shtesë të dhëna në seancën dëgjimore eksperti ka theksuar se në praktikën ndërtimore për punimet e kryera bëhen situacionet nga pune kryesit të cilat duhet të pranohen nga organi mbikëqyrës i punimeve dhe se në rastin konkret nuk është vepruar kështu.

- A. D., pronar i paditëses në dëshminë e tij të dhënë, ka deklaruar se me palën e paditur kanë qenë në një raport të më hershëm për sanimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës i cili ka qenë tender vjetor. Mirëpo pala e paditur ka kërkuar që të kryhen edhe punime tjera të cilat janë objekt i këtij kontesti . Mbi këtë kërkesë të zyrtarëve të Komunës, kanë kryer punime ndërtimore në fshatin Lugbunar dhe ndërtimin e urës mbi lumin E., më tutje ka shtuar se pas kryerjes së punimeve kanë dërguar faturat të cilat nuk janë paguar nga pala e paditur.

-dëshmitari R. R., në dëshminë e tij ka deklaruar se ka pasur pozitën e udhëheqësit të sektorit për planifikim zhvillim dhe projektim, herë pas here ka pas pozitën e projekt menaxherit, në periudhën kontestuese ka mbajtur pozitën e udhëheqësit të sektorit të resurseve natyrore dhe taksës në firma. Ka deklaruar se nuk ka dijeni në lidhje me raportin kontraktues të pretenduar nga pala paditëse, po ashtu nuk ka njohuri që Komuna e Gjakovës ka kërkuar kryerjen e punimeve kontestuese.

-dëshmitari P. B., ka deklaruar se me iniciativën e banorëve të fshatit kanë grumbulluar shumën prej 18,000.00 €, me destinim shtrimin e rrugës së fshatit dhe se këto mjete i kanë dërguar në llogari të Komunës. Kjo rrugë është shtruar në vitin 2018 nga ana e Komunës së Gjakovës.

Objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte baza juridike e kërkesëpadisë, pala paditëse me padi dhe gjatë seancave dëgjimore ka pretenduar se me dijeninë e Komunës së Gjakovës ka kryer punime ndërtimore objektin U. mbi lumin E., dhe objektin rruga lokale L., në Gj., dhe meqenëse këto punime janë realizuar me dijeninë e Komunës së Gjakovës dhe janë me interes të përgjithshëm, pala e paditur ka për detyrim kompensimin e tyre. Ka pretenduar se Komuna e Gjakovës për shkak të kryerjes së këtyre punimeve është pasuruar pa bazë juridike. Në anën tjetër pala e paditur ka pretenduar se me palën paditëse nuk kanë pasur të lidhur kontratë për punët e pretenduara dhe nuk është zhvilluar asnjë procedurë negociuese për mes Zyrës së Prokurimit Publik, andaj edhe punët e pretenduara nuk gëzojnë mbrojtje juridike.

Pasurimi bazë juridike është i përcaktuar me nenin 194 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku është përcaktuar se secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri. Mirëpo në rastin konkret pas shqyrtimit të provave të lëndës, pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundimin se paditësja dhe pala e paditur nuk kanë pasur të arritur marrëveshje apo kontratë për kryerjen e punimeve ndërtimore të cilat janë objekt i kontestit. Duke iu referuar ekspertizës së punuar nga eksperti i ndërtimtarisë ka rezultuar se përveç mungesës së kontratës kanë munguar edhe dokumentet si në vijim: projekti i pranuar; situacionet e pranuar dhe të vërtetuara nga investitori; ditarët ndërtimor; libri ndërtimor; plani dinamik për ndërtimin e objektit; procesi i pranim dorëzimit të punimeve, dhe llogaria përfundimtare e punimeve të kryera e të nënshkuara nga të dyja palët.

Gjykata e shkallës së parë vë në pah se në këtë çështje juridike kontestimore si palë kemi Komunën si organizatë buxhetore, respektivisht menaxhuese të parasë publike, e cila ka për detyrim zhvillimin e aktivitetit të tenderimit në relacion me operatorët ekonomik, siç janë: shpallja e tenderit, hapja dhe vlerësimi i ofertave, shpallja e fituesit, lidhja e kontratës, etj. Me Ligjin për Prokurimin Publik (Ligji nr. 04/L-042) janë rregulluar të gjitha aktivitetet e prokurimit që duhet të zhvilloj autoriteti kontraktues, siç është Komuna në rastin konkret, por edhe subjektet e tjera që përfshihen në këto aktivitete, siç është në rastin konkret paditësi si operator ekonomik. Me nenin 2.1 të Ligjit për Prokurimin Publik, është përcaktuar se “Ky ligj vlen për të gjitha

aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese dhe koncesionerëve të punëve, ashtu siç përcaktohen këto terme në këtë ligj. Nga këto autoritete dhe koncesionerë kërkohet që, gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre të prokurimit, t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me rregullat dhe kërkesave qenësore të këtij ligji". Më tutje, me nenin 2.2 të të njëjtit ligj, është përcaktuar se "ky ligj vlen për të gjithë personat, operatorët ekonomik, dhe ndërmarrjet, ashtu si përcaktohen këto terme në këtë ligj, që janë të përfshirë, marrin pjesë ose interesohen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitete prokurimi të rregulluara me këtë ligj; nga personat e tillë, operatorët, dhe ndërmarrjet po ashtu kërkohet që t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale të zbatueshme dhe qenësore të këtij ligji".

Gjykata e shkallës së parë në fund, përfundon se për punimet e pretenduara nga paditësja, nuk janë kryer procedurat e parapara në Zyrën e Prokurimit Publik, pra, nuk kishte shpallje të tenderit e as procedurë të negociuar me të njëjtin operator ekonomik, siç përcakton Ligji i Prokurimit Publik, andaj duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipër cituara, e njëjta gjykatë ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses në lidhje me borxhin e pretenduar është e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e sipër cekur të gjykatës së shkallës së parë duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë të dhëna në arsyetimin e këtij aktgjykim, duke shtuar se kontrata mbi ndërtimin në kuptim të nenit 630 të LMD ka qenë desht të lidhet me shkrim, ndërsa në kuptim të nenit 70 të LMD nëse kjo kontratë nuk është lidhur në formë të shkruar, ajo nuk prodhon efekt juridik. Në rastin konkret nuk është lidhur as kontratë mbi veprën në kuptim të nenit 600 të LMD, andaj paditësja nuk është desht të ndërmerr veprime pa urdhëresë me shkrim nga e paditura, andaj edhe kërkesa e saj nuk gëzon mbrojtje juridike gjyqësore.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme pranon si të bazuar qëndrimin juridik të të dy gjykatave të sipër përmendura lidhur me refuzimin si të pa bazuar të kërksëpadiës së paditëses, nga se aktgjykimet e tyre në këtë çështje kontestimore nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nejit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.

Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.

Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

Në revizionin e të autorizuarit të paditëses janë paraqitur pretendime për shkelje thelbësore procedurale nga neni 182.2 pika n, të LPK-së, se nuk janë dhënë arsye mbi disa fakte vendimtare, të rëndësishme për vendimmarrje të drejtë në këtë çështje juridike, e të cilat kanë të bëjnë me atë se paditësja i ka filluar dhe kryer punët kontestuese sipas kërkesave dhe porosisë së përfaqësuesve kompetent të paditurës, se paditëses i është premtuar se dokumentacioni gjatë apo pas punimeve do të rregullohet dhe se do të nënshkruhet kontrata e pastaj se do të bëhet pagesa për punët e kryera, se e paditura i ka pranuar punët e kryera nga paditësja.

Këto pretendime të revizionit nuk qëndrojnë si të bazuara, ngase të dy gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë gjejnë se në njërin anë, për punimet e pretenduara nga paditësja, nuk janë kryer procedurat e parapara në Zyrën e Prokurimit Publik, pra, nuk kishte shpallje të tenderit e as procedurë të negociuar me të njëjtin operator ekonomik, siç përcakton Ligji i

Prokurimit Publik, ndërsa në anën tjetër, kontrata mbi ndërtimin në kuptim të nenit 630 të LMD ka qenë desht të lidhet me shkrim, ndërsa në kuptim të nenit 70 të LMD nëse kjo kontratë nuk është lidhur në formë të shkruar, ajo nuk prodhon efekt juridik. Në rastin konkret nuk është lidhur as kontratë mbi veprën në kuptim të nenit 600 të LMD, andaj paditësja nuk është desht të ndërmarr veprime pa urdhëresë me shkrim nga e paditura, andaj edhe kërkesa e saj nuk gëzon mbrojtje juridike gjyqësore. Këto janë fakte vendimtare nga të cilat varet vendim marrja e drejtë në këtë çështje juridike, për të cilat të dy gjykatat kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të pranueshme edhe nga kjo gjykatë. Edhe Gjykata Supreme, vlerëson se në këto rrethana, porosia dhe pëlqimi i të paditurës për kryerjen e punëve të pretenduara nga paditësja, janë irelevante, pasi që , në mes palëve kontestuese as nuk ka pas të lidhur me shkrim kontratë ndërtimi, e as nuk janë respektuar procedurat e prokurimit, siç parashihet me dispozitat ligjore të sipër cekura, andaj kërkesa e paditëses për pagesën e këtyre punëve të kryera nga ajo, nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndaj , gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë vepruar kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e tillë të paditëses.

Pretendimi tjetër i revizionit se kemi të bëjmë edhe me shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2.pika o, të LPK nga se Gjykata e Apelit ka konstatuar se çështja konkrete ka të bëjë me mos përmbushje të kontratës e jo me pasurim të pa bazë, u refuzuar si e pa bazuar nga se në kuptim të nenit 253.2 të LPK gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë.

Po ashtu, u vlerësuan pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 210; 194; 630 të LMD, dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, të cilat pretendime të revizionit u refuzuan si të pa bazuara, nga se me këto pretendime as sesi nuk vihet në pikë pyetje zbatimi i drejtë i këtyre dispozitave ligjore, dhe për më tepër , edhe Gjykata Supreme gjen se zbatimi i këtyre dispozitave ligjore nga të dy gjykatat e instancës më të ultë përfaqëson zbatim të drejtë të së drejtës materiale, pasi që me të njëjtat rregullohet situata juridike ligjore kur, sikurse në rastin konkret, është e detyrueshme lidhja e kontratës së ndërtimit për tu kryer punët ndërtimore por ajo nuk është lidhur, dhe kur nuk është lidhur kjo kontratë ndërtimi në formë të shkruar duke u respektuar procedurat e parapara me Ligjin për Prokurimin Publik cili është efekti juridik në mes palëve i marrëveshjes eventuale verbale për kryerjen e këtyre punimeve. Kështu që, gjykata e shkallës së parë dhe e dytë në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Për arsyet e paraqitura më lartë, revizioni i të autorizuarit të paditëses u refuzua si i pabazuar, andaj me zbatimin e nenit 222 të LPK-së, u vendos në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

E.Rev.nr. 2/2022 datë 05.05.2022.

Kryetari i kolegjit,

Shukri Sylejmani